

DEMOS

BULETIN

DEMOS urë lidhëse mes komunës e qytetareve

Përfshirja e qytetarëve në vendim-marrje gjatë muajve të pandemisë ishte ndër preokupimet më të mëdha të komunave. Komunitat gjatë gjithë kohës ishin duke kërkuar mënyra të reja për përfshirjen e qytetarëve pa rrezikuar shëndetin e tyre. Projekti i DEMOS-it, ishte gjithmonë aty për t'i ndihmuar komunitat të realizojnë takimet me qytetarët. Duke qenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë, ekipi i DEMOS-it ka vazhduar punën nga shtëpitë dhe menjëherë ka filluar mbajtjen e gjithë aktiviteteve virtualisht, për t'i ofruar ndihmë komunave e për të ruajtur shëndetin e pjesëmarrësve.

Përfshirja e qytetarëve në vendim-marrje është një nga indikatorët kryesor të demokracisë, mirëpo shumica e komunave, si pasojë e gjendjes aktuale, e kishin thuar se të pamundur mbajtjen e takimeve të rregullta me qytetarët, dukë e bërë këtë të jetë pika e cila është ndikuar më së shumti nga kjo situatë.

Në këtë aranzhim të ri me karantinimin dhe masat e sigurisë, të gjitha përpjekjet e DEMOS janë drejtuar për të ndihmuar pushtetet lokale në vazhdimësinë e qeverisjes demokratike.

Ekipi i DEMOS-it, gjatë këtyre muajve të pandemisë, ka mbajtur takime virtuale

me kryetarët e komunave, drejtorët dhe përfaqësuesit e tjerë të komunave.

Së bashku me ta, u shqyrtuan mundësitë dhe mënyrat e ndryshme të mbështetjes që DEMOS mund të ofrojë në mënyrë që të vendosin në funksion idenë e takimeve online me qytetarët. Aty u diskutua edhe për Grantin e Performancës Komunale



dhe performancës individuale të komunave në qeverisjen demokratike, menaxhimin komunal dhe ofrimin e shërbimeve.

Gjithashtu u diskutua për sfidat me të cilat përballen komunitat dhe mundësitë për të përmirësuar performancën e tyre. Për më tepër theksuam rëndësinë e llogaridhënies, transparencës, pjesëmarrjes si parimet kryesore të çdo demokracie lokale.

Ideja prapa realizimit të takimeve online me qytetarët është mbështetja e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes si dhe ndihma ndaj komunave për të përmbushur standardet minimale të konsultimit publik mbi temat e rëndësishme. Në këtë mënyrë, komunitat do të sigurojnë transparencë më të lartë dhe llogaridhënie në drejtim të qytetarëve të tyre. Për më tepër, duke lehtësuar takimet online me qytetarët, komunitat gjithashtu mund të përmirësojnë performancën e tyre në Grantin e Performancës Komunale.

Mirëpo vetëm nëntë nga tridhjetë e gjashtë komunitat e kontaktuar kanë shprehur interesin e tyre për të pasur takime online me qytetarët dhe më pas vetëm 5 prej tyre kërkuan mbështetjen tonë.

Edhe pse ekziston një numër i madh i përdoruesve të mediave sociale, interesimi i qytetarëve për të marrë pjesë në takime online ishte shumë i vogël, ndërsa numri i grave pjesëmarrëse edhe më i ulët. Kjo na tregon që duhet të hulumtohen mundësitë të reja dhe inovative për të stimuluar interesim më të madh të qytetarëve lidhur me çështjet publike dhe për të mbajtur llogaridhënës përfaqësuesit e tyre komunalë.

“

“Situata e krijuar rishtazi, jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë globin, mund të shihet jo vetëm si krizë shëndetësore, por edhe si një mundësi për të ndryshuar dhe përvetësuar mënyra të ndryshme se si të shfrytëzohet më mirë teknologjia në dispozicion, të zhvillohen kanale dhe mekanizma të rinj të pjesëmarrjes në mënyrë që të ngushtohet hendeku midis vendimmarrësve dhe qytetarëve”

DEMOS project



Komunat që kanë mbajtur takime online me qytetarët

Komuna e Gjilanit
Komuna e Rahovecit
Komuna e Klinës
Komuna e Kamenicës dhe
Komuna e Prishtinës






Trajnimet si zgjidhje për të përmirësuar performancën

Këtu në DEMOS trajnimet për ngritjen e kapaciteteve kanë vazhduar edhe përmes ekraneve të kompjuterëve. Gjatë viteve, duke iu referuar rezultateve të performancës komunale, raporteve të auditimit dhe raportit të vlerësimit të nevojave, stafi i DEMOS-it ka krijuar skemën e nevojave për trajnim, duke iu referuar pikave më të dobëta të performancës komunale. Qëllimi i këtyre trajnimeve është të ndihmojnë komunat të forcojnë performancën e tyre drejt qeverisjes dhe menaxhimit demokratik.

Për të kuptuar dhe zbuluar më mirë sfidat më të zakonshme dhe nevojat për ngritjen e kapaciteteve të komunave në Kosovë, DEMOS ka mbajtur një takim virtual me përfaqësues nga komuna të ndryshme, të cilët kanë plotësuar pyetësorët duke zgjedhur trajnime prioritare nga një listë e temave të propozuara, dhe gjithashtu kanë identifikuar sfida shtesë, specifike për komunat.

Rezultatet e pyetësorëve theksuan nevojën për të organizuar trajnime në fushën e “zbatimit të rekomandimit të auditimit” dhe “diskutimit të raportit të perfor-



mancës komunale në asamblëtë komunale”.


Trajnimet mbi rekomandimet e auditorëve të jashtëm dhe raportimi mbi performancën komunale janë ndarë në katër module, të cilat u janë ofruar zyrtarëve komunalë dhe anëtarëve të kuvendit të të gjitha komunave në Kosovë.

“Modulet janë shumë specifike dhe të rëndësishme për nevojat e komunave dhe janë shumë të dobishme dhe konkrete për t’u zbatuar në praktikë”, shpjegon Merita Barileva, Menaxhere e Ndërhyrjes në DEMOS.

Si pjesë e trajnimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit, rreth 100 zyrtarë komunalë kanë marrë pjesë dhe kanë fituar njohuri dhe aftësi të reja në lidhje me sistemet e kontrollit dhe menaxhimin e rrezikut, planifikimin dhe buxhetimin e investimeve kapitale, procesin e menaxhimit të projektit dhe raportimin financiar.

Sipas Dardan Maliqit, trajnimet u shërbejnë komunave për të rritur performancën e tyre dhe për t’u zhvilluar në mënyrë që të njëjtat rekomandime të auditorit të mos përsëriten.

“Qëllimi i trajnimit në internet është të ndihmojë zyrtarët komunalë të përmirësojnë performancën e tyre në lidhje me Grantin e Performancës Komunale. Trajnimi ka të bëjë me adresimin e nevojave reale të trajnimit të zyrtarëve komunalë në fushën e menaxhimit komunal, me një fokus të veçantë në treguesin që adreson rekomandimet e auditorit të jashtëm që do të kontribuojë në rritjen e performancës komunale,



dhe për pasojë të mos përsëriten të njëjtat rekomandime për adresimi i ardhshëm në lidhje me këtë tregues', tha ai.

Modulet e trajnimit, sistemi i menaxhimit të performancës, qeverisja demokratike, menaxhimi komunal dhe shërbimet komunale ishin pjesë e diskutimit të raportit të performancës komunale në trajnimin e kuvendëve komunale dhënë të më shumë se 350 anëtarëve të kuvendëve komunale dhe zyrtarëve të tjerë përkatës komunalë.

Zyrtarët komunalë që morën pjesë në këto trajnime konsiderojnë se trajnimet janë gjithashtu të nevojshme edhe për njerëzit që kanë punuar në institucione për vite me radhë.



'Këto trajnime janë të domosdoshme, përkundër faktit se disa prej nesh kanë qenë për një kohë të gjatë në institucione, dhe ndryshimet në procese dhe rifreskimin e njohurive nga trajnerët dhe shkëmbimet në mes kolegëve (pjesëmarrësit komunalë) kanë qenë të jashtëzakonshme, "tha Xhevahire Rushiti, Zyrtare Kryesore Financiare në komunën e Mamushës.

Jetush Rrafshi, një auditor nga komuna e Shtimes, ndan të njëjtin mendim.

"Trajnimet e mbajtura kanë qenë jashtëzakonisht të domosdoshme, pasi kemi nevojë për trajnime të tilla me fokus në rifreskimin e njohurive mbi menaxhimin financiar dhe plotësimin e programeve trajnuese të nevojshme për Organizatat Buxhetore", tha ai.

Përveç pjesëmarrësve që kanë përfutur nga këto trajnime, ata gjithashtu kanë kaluar informacionin e marrë edhe tek zyrtarët e tjerë.

'Për mua personalisht ato kanë pasur një efekt shumë pozitiv pasi kam fituar njohuri të reja nga të gjitha modulet. Unë gjithashtu ia përcolla materialin e të gjitha moduleve të gjithë drejtorëve në mënyrë që ato të mund të përcillen tek zyrtarët e tyre', tha Xhevahire Rushiti, pjesëmarrëse.

Këtë vit, situata pandemike kishte bërë që trajnimet të mbaheshin përmes internetit, ku përveç disa problemeve të vogla teknike, nuk kishte asnjë pengesë në marrjen e njohurive.

"Reathanat nën të cilat u zhvilluan trajnimet këtë vit kanë shkaktuar kufizim të pjesëmarrjes dhe kryerjes së trajnimit, por në çdo rast ato ndihmuan në rifreskimin e njohurive tona mbi zbatimin e rekomandimeve nga Raportet e Auditorëve dhe udhëzimet e reja për investime dhe projekte kapitale nga Ministria e Financave si dhe menaxhimi i projektit si temë e re nga projekti DEMOS", tha Jetush Rrafshi.

Përveç trajnimit, DEMOS gjithashtu mban programe komunikimi ose avokimi për ato fusha ku trajnimi nuk është zgjidhja, siç është përfshirja e grave në takime publike, si një nga treguesit më të dobët, i cili është më shumë një produkt i normave shoqërore që mund të zgjidhet përmes komunikimit ose avokimit për të promovuar përfshirjen e grave.

DEMOS zhvillon trajnime vetëm në zona dhe komuna ku institucionet dhe organizatat e tjera nuk kanë ofruar mbështetje për ngritjen e kapaciteteve. Gjithashtu, për t'i bërë trajnimet më të kuptueshme, ato organizohen në grupe më të vogla.

Mbahet trajnimi për Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale

Me 22 dhjetor të vitit të kaluar Ministria e Pushteti Lokal në bashkëpunim me projektin DEMOS filluan me mbajtjen e trajnimeve për përdorimin e Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale. Në këto trajnime kanë marr pjesë koordinatorët për performancë komunale dhe zyrtarët raportues të komunave.

Sistemi elektronik do të fillojë të aplikuar në vitin 2021, me rastin e ciklit të radhës së matjes të performancës

së komunave. Ky sistem ofron mundësinë e raportimit online të performancës, zvogëlon barrën administrative për matje të performancës komunale, rritë sigurinë e të dhënave, cilësinë dhe dokumentimin e tyre, lejon qasje krahasimore të të dhënave sipas fushave dhe treguesve për periudha të pakufizuara kohore, si dhe ofron qasje direkte për qytetarët lidhur me performancën e komunave.



BËHU ZËRI I QYTETIT TËND

#BëhuZëriIQytetitTënd

Përfshirja e qytetareve në vendimmarrje është ndër pikat kryesore të qeverisjes demokratike. Mirëpo, sipas raportit të performancës, ky indikator ka një përqindje të vogël të zhvillimit.


Në vitin 2019, vetëm 1.51% nga numri total i qytetarëve të Kosovës kanë marrë pjesë në takime të organizuara nga komunat në gjithë Kosovën,

Hallet, problemet e nevojat e qytetarëve dëgjohen atëherë kur ata i paraqesin këto para komunës, mospjesëmarrja në vendimmarrje në komunë nga qytetarët pamundëson dëgjimin e zërit të tyre.

Kështu, për të treguar rëndësinë e përfshirjes të qytetarëve, DEMOS ka filluar fushatën 'Bëhu Zëri i Qytetit Tënd'

Në kuadër të kësaj fushate janë realizuar tri video vetëdijesuese: Qytetari për komunën, Pjesëmarrja e qytetareve në vendimmarrje dhe Komuna për qytetarin.

BËHU ZËRI I QYTETIT TËND



Përmes të cilave është njoftuar opinioni publik mbi atë se sa kanë pjesëmarrja në vendimmarrje, dhe sa e rëndësishme është që komuna të kërkojë përfshirjen e qytetarëve dhe anasjelltas, sa e rëndësishme është përfshirja e qytetarëve për komunën.

Për një qeverisje demokratike, komuna duhet të dëgjoj qytetarin, ndërsa qytetari duhet t'i shpreh problemet dhe interesat e veta.

Në vazhden e kësaj kampanje është mbajtur edhe webinar mbi pjesëmarrjen dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje lokale gjatë pandemisë. Në këtë webinar kanë marrë pjesë përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, komunat, profesorë dhe studentë nga UBT - Universiteti për Biznes dhe Teknologji, Kolegji Riinvest International - LSE në Kosovë dhe Universiteti i Prishtinës

Ertan Munoglu, menaxher i projektit DEMOS, në këtë takim, paraqiti shqetësimin për pjesëmarrjen e ultë të qytetarëve në takime publike ndër vite dhe gjithashtu përmendi




di sfidat lidhur me takimet virtuale të komunave të organizuara me mbështetjen e projektit DEMOS.

Kryetari i komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, dhe kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, prezantuan sfidat dhe problemet që këto komuna janë përballur gjatë kësaj periudhe të pandemisë dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Gjithashtu, Ngadhnjim Halilaj menaxher i projektit D4D, prezantoi raportin mbi performancën e komunave në fushën e komunikimit me qytetarë.

Pjesë e webinarit ishin edhe student të cilët u interesuan për qeverisjen komunale dhe çfarë mund të bëjnë për përfshirjen e numrit më të madh të qytetarëve në të ardhmen.



Cfarë rëndësie ka Granti i Përformancës Komunale për komunat?



‘Granti i Përformancës ka fuqizuar dhe promovuar rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetar ruajtjen e mjedisit, shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve, zhvillimin e turizmit si parakusht për zhvillimin ekonomik lokal’ –

Agron Kuqi,
Kryetar i Komunës së Junikut



Të jeni pjesë e një konkurrence të shëndoshë është dëshmi e përpjekjes për ofrimin e shërbimeve publike sa më cilësore për qytetarët’-

Rufki Suma,
Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit



‘Granti i Përformancës për Komunën e Dragashit ka një rëndësi të veçantë ngase mundëson mbështetjen e projekteve të rëndësishme të bazuara në komunitet. Stimulon qeverisjen lokale në përmirësim të vetvetes dhe krijon mundësi për të arritur rezultate më të mira në ngritjen e transparencës, përfshirjes së qytetarëve dhe cilësisë së qeverisjes në të gjitha fushat’

Shaban Shabani,
Kryetar i Komunës së Dragashit



‘Granti i Përformancës është sfidë për komunën tone. Përmes tij mundohemi që t’i përmirësojmë shërbimet të cilat komuna i odron për qytetarëve. Nrisim vetëdijën dhe i afirmojmë të përfshihen në punën e komunës dhe në proceset e vendimmarrjes. Granti na mundëson që përpos ngritjes së kushteve të jetës së qytetarëve tanë, të stimulojmë edhe punën e departamenteve dhe shërbimeve tonë’-

Vladica Aritonovic,
Kryetar i Komunës së Ranillugut.



ÇKA DO TE THOTË KOMUNA E HAPUR DHE TRANSPARENTE

Transparencë e plotë, qasje në dokumente publike dhe pjesëmarrje të qytetarëve në procese për interes të përgjithshëm, e bëjnë komunën më të besueshme dhe më të hapur karshi qytetarëve.


Shërbime më të mira si në: shëndetësi, arsim, mbrojtje të mjedisit dhe infrastrukturë.



Parandalojmë korrupsionin përmes transparencës komunale, raportimit dhe zbatimit të planit të integritetit dhe fuqizimit të shoqërisë civile.

ÇKA PËRFITJMË ME KOMUNËN E HAPUR DHE TRANSPARENTE

Kursejmë paratë publike përmes prokurimit të hapur dhe transparent, duke publikuar dokumentet dhe kontratat.



Përfitojmë besimin e qytetarëve dhe forcojmë llogaridhënjen përmes takimeve të kuvendit të komunës të bëra publike dhe publikimit të procesverbaleve për proceset e konsultimeve publike.

Transparenca, qasje në informata dhe integriteti

Sipas Raportit të Performancës Komunale 2019, të dhënat në lidhje me treguesit në fushën e transparencës të raportuara nga 36 komuna të Kosovës.

